

VENDIM
Nr.259, datë 3.10.2011

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV GRAMSHI”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Alban Karapici	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Gramshi”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 dhe neni 33 pikat 1 dhe 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VËREN SE:

Me vendimin nr.22/4, datë 23.10.2000, KKRT-ja ka licencuar shoqërinë “Kosturi” sh.p.k. për televizionin privat vendor “TV Gramshi”. Bazuar në vendimin nr.460, datë 11.5.2006, KKRT-ja ka rinovuar licencën e subjektit për një afat të ri 5-vjeçar. Në përfundim të afatit të licencimit, me shkresën nr.802 prot., datë 13.7.2010, KKRT-ja ka njoftuar subjektin për përfundimin e saj, duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës. Meqenëse subjekti nuk kishte shfaqur interes, KKRT-ja, në mbledhjen e datës 28.3.2011, ra dakord që subjekti të njoftohet dhe t’i lihet përsëri në dispozicion një afat i ri 30-ditor për të depozituar kërkesën së bashku me dokumentacionin për rinovimin e licencës.

Pavarësisht njoftimit të dytë, nr.569 prot., datë 4.4.2011, rezulton se deri më tani, ky subjekt nuk ka paraqitur kërkesë apo aplikim për rinovimin e saj.

KKRT-ja konstaton se afati i vlefshmërisë së licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Gramshi” ka përfunduar në datën 9.11.2010.

Gjithashtu, KKRT-ja vëren se subjekti “TV Gramshi” ka detyrime financiare të pashlyera ndaj KKRT-së në vlerën 28.600 lekë pagesë për licencë dhe 24.000 lekë taksë për shërbimet rty,

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe nenit 33 pikat 1 dhe 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën me nr.004/TVL, të subjektit televiziv privat vendor “TV Gramshi”.
2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati